



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 592 Akti

Nr. 598 Vendimi
Tiranë, më 13.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko Kryesuese
Roland Ilia Relator
Brunilda Bekteshi Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 7.12.2022, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Genci Mane**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Genci Mane,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Genci Mane, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin qershor të vitit 2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Genci Mane do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bektashi.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjyqësor komisionere Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Genci Mane nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit me nr. *** prot., datë 30.3.2018, i ILDKPKI-së, protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 17.6.2020, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

9. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2022 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 19.9.2022, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

10. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe nga të dhënat arkivore të këtij Këshilli. Raporti i KLP me nr. *** prot., datë 29.9.2022, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit është administruar nga Komisioni.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 22.11.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Genci Mane; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 22.11.2022 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjektit iu la kohë për njohjet me dosjen e Komisionit dhe ushtri të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja.

14. Subjekti i rivlerësimit ka dërguar shpjegimet e tij në rrugë zyrtare në datën 2.12.2022. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 5.12.2022, vendosi të ftojë z. Genci Mane në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit Genci Mane u ftua në seancën dëgjimore të datës 7.12.2022 me njoftimin e bërë në rrugë elektronike.

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 7.12.2022, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Genci Mane kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Genci Mane ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova e shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas

mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar pranë Komisionit, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka paraqitur pranë Komisionit raportin e vlerësimit për subjektin Genci Mane.

24. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

25. Z. Genci Mane është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367,

nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë, si vijon:

- para fillimit të detyrës 2003;
- periodike vjetore për vitet 2004 – 2017;
- deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

27. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Genci Mane, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar - *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Genci Mane dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Banesë në qytetin e Beratit

1.1 Banesë me sip. 82 m², plus verandë dhe oborri me sip. 57m², në lagjen “****”, Berat (privatizimi), sipas kontratës së dhurimit dhe shitja nga Ndërmarrje Komonale Banesa Berat e datës 18.5.1993.

1.2 Burimi i krijimit: kursimet e pagës si përmbaues gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Pagesa: 12,704 lekë. Pjesa takuese: 25%.

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.3 Bazuar në “Vërtetimin nga dokumenti hipotekor” të datës 19.2.2002, kjo pasuri është me sip. 82 m² dhe është regjistruar në emër të shtetasve P, Sh, G dhe A.M. Pasuria mban nr. ***, z. k. ***, në lagjen “***”, Berat.

1.4 Bazuar në vërtetimin nga dokumenti hipotekor, datë 19.2.2002, rezulton e regjistruar dhe pasuria truall me nr. ***, z. k. ***, me sip. 57m², në lagjen “***”, në emër të shtetasve P, Sh, Genci dhe A.M.

1.5 Bazuar në dokumentacionin shoqërues të ZVRPP Berat, rezultoi një kontratë dhurimi dhe shitje e pasurisë së paluajtshme apartament, datë 18.5.1993, me palë shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa dhe blerës P. M dhe pranuesit e dhurimit – Sh, Genci dhe A. M.

1.6 Bazuar në mandatarkëtimin nr. *** është paguar shuma prej 12,704 lekësh, kjo shoqëruar me kontratën e privatizimit të banesës datë 12.5.1993, planimetrinë e apartamentit dhe certifikatën e përbërjes familjare.

1.7 ZVRPP-ja Berat² ka konfirmuar se në emër të shtetasve P, Sh, Genci dhe A.M figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, z. k. ***, me sip. 82 m² dhe nr. ***, z. k. ***, me sip. 57 m², me adresë në lagjen “***”.

1.8 Në deklaratën para fillimit të detyrës subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën takuese në apartamentin me sip. 82 m² plus verandë dhe oborr me sip. 57m² në lagjen “***”, Berat. Këtë pasuri subjekti e ka deklaruar për herë të parë në DPV/2004.

1.9 Me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 1.2.2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e pjesës takuese në vlerën 1,700,000 lekë, në pasurinë e përbashkët apartament me sip. 82m² dhe truall me sip. 57 m², në Berat (trajtuar dhe më poshtë në pikën 2 të këtij vendimi).

1.10 Pas verifikimit, hetimit dhe administrimit të dokumentacionit lidhur me këtë pasuri, rezultoi se ajo është përfituar nga subjekti dhe familja e tij e origjinës me anë të privatizimit në vitin 1993, shumë kohë përpara se subjekti i rivlerësimit të fillonte detyrën si prokuror.

1.11 Konkluzioni i Komisionit

Nisur nga vlera e blerjes së pasurisë dhe periudha përkatëse nuk janë konstatuar problematika për këtë pasuri.

2. Banesë në qytetin e Fierit

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë banesë me sip. 140 m², në lagjen “***”, Fier dhe 15 m², sipërfaqe e përbashkët. Vlera: 4.650.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

2.2 Burimi i krijimit:

- kredi në shumën 2.900.000 lekë, në Bankën Kombëtare Tregtare;
- deklarata noteriale për shitjen e pjesës takuese banesë e përbashkët ndodhur në lagjen “***”, Berat, të pasurisë nr. ***, sip. 82m² dhe nr. ***, sip. 57m², në shumën 1.700.000 lekë;

²Shihni përgjigjen e ish-ZVRPP-së Berat në dosjen e ILDKPKI-së.

- kursimet nga paga.

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.3 Bazuar në vërtetimin hipotekor të datës 17.4.2013, apartamenti me sip. 140 m² është në emër të shtetasve Genci dhe O.M.

2.4 Për këtë pasuri rezulton një kontratë shitjeje pasurie me kusht kreditimi nga banka nr. ***, datë 4.2.2013, ku shtetasi Genci Mane përfiton apartamentin me sip. 140 m², me vlerë 4,650,000 lekë. Pala shitëse i njeh palës blerëse afatin deri më 25.4.2013, brenda të cilit kjo palë duhet të marrë të gjitha masat dhe të tregojë vullnetin maksimal për miratimin dhe disbursimin e kredisë.

2.5 Sipas kontratës së shitjes me kusht, vlera e kontratës do të lëvrohet:

- kësti i parë në masën 1,750,000 lekë është paguar nga pala blerëse para nënshkrimit të kontratës;
- kësti i dytë në masën 2,900,000 lekë do të paguhet përmes një kredie bankare të miratuar nga Banka Kombëtare Tregtare në favor të palës blerëse dhe disbursuar në llogarinë bankare të palës shitëse.

2.6 Bazuar në pikën 7 të kontratës “Kalimi i pronësisë”, citohet, ndër të tjera, se për efekt të përmbylljes së procedurave të disbursimit të kredisë dhe dhënies së garancive të nevojshme ndaj bankës huadhënëse, pavarësisht mungesës së pagimit të plotë të çmimit kontraktor, pala blerëse ka të drejtën e regjistrimit (transkriptimit) të kontratës pranë ZVRPP-së Fier, me emrin e vet, menjëherë pas miratimit në parim të kredisë bankare. Palët parashikojnë gjithashtu që kjo kontratë do të regjistrojë një hipotekë (inskriptim) mbi pasurinë objekt kontrate në favor të palës shitëse, me qëllim që të mbrojë interesat ekonomikë e juridikë të kësaj pale në periudhën kohore deri në disbursimin e kredisë.

2.7 Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.4.2013, konstatohet se pala blerëse Genci Mane i ka likuiduar *cash* në dorë palës shitëse “****” sh.p.k. shumën 1,750,000 lekë, si dhe në ditën e nënshkrimit të deklaratës këstin e dytë prej 2,900,000 lekësh. Pala shitëse deklaroi se është dakord që pasuria të regjistrohet në emër të shtetasit Genci Mane, pasi është likuiduar totalisht për të gjithë vlerën e shitjes.

2.8 Pra, sipas kësaj deklarate noteriale, datë 15.4.2013, subjekti i ka likuiduar shoqërisë “****” sh.p.k., në ditën e nënshkrimit të deklaratës, këstin e dytë prej 2,900,000 lekësh, ndërsa sipas *statement*-it bankar nga BKT-ja figuron disbursimi i kredisë në shumën 2,900,000 lekë, datë 3.5.2013, dhe transfertat e shumës në datën 7.5.2013 për likuidimin e blerjes përfundimtare të apartamentit në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

2.9 Lidhur me mosrakordimin e datës së pagesës dhe disbursimit të kredisë është pyetur subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar³: “... për sa i takon deklaratën noteriale të datës 15.4.2013, ajo është në vazhdimësi të kontratës së shitblerjes së datës 4.2.2013, ku në këtë kontratë është parashikuar shitja e pasurisë me kusht kreditimi dhe regjistrimi apartamenti në emrin e palës blerëse para disbursimit të kredisë”.

³Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. *** prot., datë 5.8.2022.

2.10 Këtë mosrarakordim lidhur me datat dhe pagesat palët e kanë specifikuar në kontratën e shitjes me kusht (shihni përmbajtjen e kontratës së shitjes në datën 4.2.2013).

2.11 Rezultoi se pasuria në fjalë ka qenë e regjistruar fillimisht në emër të palës shitëse, shoqëria “****” sh.p.k., e cila është pajisur me lejen e shfrytëzimit e të gjithë objektit në datën 26.9.2011, sipas vendimit nr. ***, datë 18.7.2005, të KRRT-së Fier, për dhënien e lejes së ndërtimit.

Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie

a. Shuma e deklaruar prej 1,700,000 lekësh

2.12 Për të provuar deklaratimet e tij subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale nr. ***, datë 1.2.2013, për shitjen e pjesës takuese në vlerën 1,700,000 lekë, të pasurisë së përbashkët apartament me sip. 82m² dhe truall me sip. 57m² te prindërit e tij. Gjithashtu, subjekti deklaroi se në momentin që prindërit do ta çmojnë të arsyeshme dhe do të përgatisin dokumentacionin, do të paraqitet te noteri për të nënshkruar kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë me ¼ pjesë takuese nga emri i tij në emrin e prindërve.

2.13 Nisur nga fakti se nuk provohej kalimi i shumës prej 1,700,000 lekësh nga prindërit të subjekti, si dhe për të provuar mundësitë financiare të prindërve për krijimin e kësaj shume, u pyet subjekti i rivlerësimit⁴.

2.14 Në përgjigje të pyetësorëve⁵ subjekti ka deklaruar: *“Deklaroj se burimi i krijimit të shumës prej 1,700,000 lekësh është nga shitja e pjesës takuese të banesës së përbashkët të familjes së origjinës, ndodhur në qytetin e Beratit. Materializimi i këtij vullneti është dokumentuar me deklaratën noteriale të datës 1.2.2013.*

*Të ardhurat e prindërve nga pensioni kanë qenë në shumat 3,560,719 lekë dhe 5,342,335 lekë. Gjithashtu, babai ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “****” për periudhën shtator 2007 – nëntor 2012, ku ka realizuar të ardhura në shumën prej 3,985,000 lekësh”.*

2.15 Për të provuar deklaratimet lidhur me mundësinë financiare të prindërve për krijimin e shumës 1,700,000 lekë, subjekti ka paraqitur si provë vërtetimin e datës 11.4.2016, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., ku deklarohet se babai i subjektit, z. Sh.M, është angazhuar si specialist pranë kësaj shoqërie në periudhën shtator 2007 – nëntor 2012. Kjo shoqëri, me shkresën e datës 12.7.2022 drejtuar subjektit të rivlerësimit, ka paraqitur të ardhura, që sipas saj ka përfituar babai i subjektit për periudhën e punësimit pranë kësaj shoqërie, si dhe licencën përkatëse si drejtues teknik.

2.16 Komisioni, lidhur me konfirmimin e të ardhurave të babait të subjektit të rivlerësimit, iu drejtua me shkresë shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2.17 Shoqëria “****” sh.p.k., me shkresën nr. *** prot., datë 19.8.2022, ka sqaruar se: *“Indjeri z. Sh.M ka ofruar shërbim për shoqërinë “****” sh.p.k. në fushën e konsulencës për ndërhyrjet dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, për periudhën kohore shtator 2007 – nëntor 2012. Për këtë periudhë kohore, i ndjeri z. Sh.M është paguar në shumën totale*

⁴Shihni pyetësorët nr. *** dhe *** dërguar subjektit nga Komisioni.

⁵Shihni përgjigjet e pyetësorëve në datat 17.6.2022 dhe 22.7.2022.

3,985,000 lekë, shumë të cilën e tërhiqte çdo muaj pranë shoqërisë ‘***’ sh.p.k., pasi nuk ishte i punësuar i brendshëm i shoqërisë”.

2.18 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2022, ka deklaruar se: “... në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e shoqërisë ‘***’, për shtetasin Sh.M si punëmarrës, DPT-ja ju bën me dije se organi tatimor vepron si agjent i mbajtjes së tatimit për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk merret me administrimin e tyre. Theksojmë se nga sistemi informativ i DPT-së për periudhën para datës 1.1.2012 nuk mund të marrim ndonjë informacion në lidhje me listëpagesat e ndonjë subjekti privat apo shtetëror, por një informacion të tillë mund ta gjeni pranë ISSH-së”.

2.19 Komisioni pyeti subjektin⁶ e rivlerësimit lidhur me qëndrimin dhe blerjen e pasurive të paluajtshme nga prindërit pas ardhjes së tyre në qytetin e Tiranës.

2.20 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti deklaroi se: “Nga komunikimi me nënën time P.M, e datëlindjes 21.3.1938 (84 vjeçe), pasi ati im Sh.M ka vdekur në datën 21.3.2019, më ka vënë në dijeni dhe dispozicion kontratën e sipërmarrjes së datës 9.3.2004, për porositjen e një apartamenti ndodhur në rrugën ‘***’, Tiranë, për të cilën është paguar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 9.3.2004, shuma 61,946 euro. Bashkëlidhur po ju dërgoj kopje të kontratës së sipërmarrjes dhe mandatit të pagesës”.

2.21 Në përfundim, lidhur me mundësitë financiare të prindërve të subjektit për dhënien e shumës prej 1,700,000 lekësh, Komisioni hartoi analizën financiare.

2.22 Nga analiza financiare duket se prindërit e subjektit nuk kishin burime të mjaftueshme financiare për përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe dhënien e vlerës së deklaruar prej 1,700,000 lekësh subjektit në datën 1.2.2013, pasi rezultuan në një pamundësi prej 463,016 lekësh.

2.23 Në këtë analizë financiare nga Komisioni u përfshinë vetëm të ardhurat nga pensionet e përfituara ndër vite nga prindërit e subjektit. Të ardhurat e pretenduara të babait të subjektit nga shoqëria “***” sh.p.k. nuk janë përfshirë në analizë financiare, për arsye se nuk është provuar pagimi i detyrimeve tatimore përkatëse.

2.24 Pas një vlerësimi lidhur me vlerën e tregut për apartamentin në qytetin e Beratit, duket se subjekti i rivlerësimit u ka shitur prindërve pjesën e tij takuese të pasurisë banesë dhe truall me një vlerë më të lartë sesa vlera e tregut në vitin 2013.

2.25 Bazuar në vlerën e referuar në VKM-në Nr. 514, datë 30.7.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për çdo rreth të Republikës së Shqipërisë”, toka me sip. 57 m² për vitin 2013 do të kishte vlerën 57m² x 4,562 lekë/m² = 260,034 lekë.

2.26 Sipas Entit Kombëtar të Banesave, çmimi i tregut të apartamenteve në Berat në vitin 2013 ishte në vlerën 45,000 lekë/m². Ekzistojnë dy mundësi për të konkluduar për vlerën e banesës:

⁶Shihni pyetësorin nr. *** drejtuar subjektit të rivlerësimit.

i. Metoda I duke aplikuar një koeficient 70% (e njëjta metodë që përdor ZRVPP-ja për vlerësimin e pasurisë në vitin 2017), në zbatim të pikës 5, germa “e” e udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin për kalimin e të drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar.

ii. Metoda II duke mos aplikuar atë koeficient.

Metoda I	Metoda II
Nëse aplikojmë koeficientin, vlera e apartamentit në vitin 2013 do të kishte qenë: $82 \text{ m}^2 \times 45,000 \text{ lekë} \times 0,7 = 2,583,000 \text{ lekë}$	$82 \text{ m}^2 * 45,000 \text{ ALL} = 3,690,000 \text{ lekë}$

2.27 Pra, sipas këtij vlerësimi, apartamenti në Berat në vitin 2013 do të kishte kushtuar:

- i. $2,583,000 \text{ ALL} + 260,034 \text{ ALL} = 2,843,034 \text{ ALL}$ (dhe pjesa takuese e subjektit 710,759 ALL);
- ii. $3,690,000 \text{ ALL} + 260,034 \text{ ALL} = 3,950,034 \text{ ALL}$ (dhe pjesa takuese e subjektit 987,509 ALL).

2.28 Pra, nga kjo analizë duket se vlera e shitjes së pjesës takuese nga subjekti tek prindërit e tij është më e madhe se vlera e saj në tregun e lirë.

b. Shuma e deklaruar prej 2,900,000 lekësh

2.29 Me anë të kontratës për kredi bankare nr. ***, datë 25.4.2013, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja O.M kanë marrë kredi në shumën 2,900,000 lekë për blerje shtëpie.

2.30 Bazuar në *statement*-in bankar nga BKT-ja⁷ figuron disbursimi i kredisë në shumën 2,900,000 lekë, datë 3.5.2013, si dhe transfertat e shumës datë 7.5.2013 për likuidimin e blerjes përfundimtare të apartamentit në favor të shoqërisë “****” sh.pk., si dhe likuidimet e kësteve të kredisë.

2.31 Për qëllimin e disbursimit të kredisë është lidhur edhe një kontratë hipotekimi nr.***, datë 25.4.2013, për apartamentin me sip. 140 m^2 , në favor të BKT-së.

2.32 Afati i kredisë bankare është 180 muaj me këst mujor 20,000 lekë. Detyrimi i mbetur deri në plotësimin e deklaratës *Vetting* është në vlerën 2,310,956 lekë⁸.

2.33 Kredia e përfituar nga subjekti i ka kaluar më pas palës shitëse në rrugë bankare, në datën 7.5.2013 (shihni *statement*-in e BKT-së në dosjen e Komisionit).

2.34 Veprimi për kontratën e shitjes është konfirmuar dhe nga DPPP-ja⁹, ku sipas saj raportimeve të kontratave noteriale për shtetasin Genci Sh Mane në datën 4.2.2013¹⁰ ka blerë një apartament me çmim të deklaruar 4,650,000 lekë nga pala shitëse shtetasi Y.I, i datëlindjes 14.2.1953, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***.

⁷Shihni shkresat e BKT-së në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

⁸Shihni vërtetimin nr. ***, datë 24.1.2017, të BKT-së.

⁹Shihni shkresën nr. ***, datë 10.5.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰Sipas kontratës nr. ***, nënshkruar para noteres S.X, me NIPT ***.

2.35 Lidhur me përfitimin e kredisë Komisioni pyeti subjektin, i cili në përgjigje të pyetësorit¹¹ deklaroi se: *“Bashkëlidhur po ju dërgoj kopje të praktikave për përfitimin e kredisë, ndodhur në Bashkinë Fier, dhe BKT-së dega Fier, si edhe ju informoj se nuk ka pasur asnjëherë çështje penale me subjektin Bashkia Fier, për këtë ju vendos në dispozicion edhe përgjigjen nr. ***, datë 22.9.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”.*

2.36 Nga praktika e dërguar rezultoi se subjekti ka aplikuar për kredi të butë pranë Bashkisë Fier në datën 16.10.2009. Për këtë aplikim ka paraqitur edhe dokumentacionin e nevojshëm si pjesë të praktikës.

2.37 Me vendimin nr. 46, datë 30.10.2012, Këshilli i Bashkisë Fier ka miratuar listat emërore të familjeve të pastreha, që kanë të drejtë të përfitojnë kredi me kushte lehtësuese. Bashkëlidhur këtij vendimi duket se është edhe lista emërore e familjeve të pastreha që do t'i përcillen institucioneve përkatëse për të përfituar kredi me kushte lehtësuese. Në këtë listë përfshihet dhe emri i subjektit të rivlerësimit Genci Mane.

2.38 Bazuar në vërtetimin nr. ***, datë 22.9.2022, të Prokurorisë së Rrethit Fier, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur ndonjë çështje penale me palë Bashkinë Fier.

2.39 Gjatë hetimit rezultoi se BKT-ja ka lidhur kontratën e kredisë me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij në datën 25.4.2013. Kontrata është lidhur bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, VKM-ja Nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve publikë” udhëzimeve të Ministrisë së Punëve Publike dhe Ministrisë së Financave.

2.40 Bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk plotësonte kriteret ligjore për t'u kualifikuar si përfitues i kësaj kredie dhe për këtë kërkoi shpjegime në rezultatet e hetimit.

c. Kursime nga pagat

2.41 Rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar ndonjëherë kursime *cash* në deklaratat periodike vjetore. Prandaj, si kursime nga pagat, që mund të shërbejnë si burim për blerjen e kësaj pasurie, mund të shërbejnë vetëm të ardhurat nga pagat e marra deri në momentin e pagesës së pranuar në kontratën e shitblerjes së datës 4.2.2013.

2.42 Sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë, palët pranojnë se kësti i parë prej 1,750,000 lekësh është paguar para nënshkrimit të kontratës. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar në DPV/2009 se është paguar vlera 100,000 lekë në vitin 2009. Nisur nga këto rrethana është analizuar mundësia e subjektit për të paguar shumën e mbetur prej 1,650,000 lekësh në vitin 2013.

2.43 Nga analiza financiare (duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e subjektit, pa përfshirë vlerën përfituese nga prindërit prej 1,700,000 lekësh) subjekti rezultoi në një pamjaftueshmëri për pagesën e vlerës prej 1,650,000 lekë për blerje apartamenti, shtimin e

¹¹Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr. ***.

likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën sipas burimeve të deklaruara.

2.44 Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite:

- Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Pagesa e këstit të parë prej 100,000 lekësh për blerjen e apartamentit me vlerë 4,650,000 lekë, sipas kontratës për shitjen e sendit në të ardhmen nr. ***, datë 17.9.2009. Detyrimi i mbetur prej 4,550,000 lekësh, detyrim ky i rideklaruar deri në vitin 2012”*.

- Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2013, subjekti ka deklaruar apartament me sip. 140 m², në lagjen “****”, Fier + 15 m² sipërfaqe e përbashkët. Kredi në Bankën Kombëtare Tregtare në shumën 2,900,000 lekë. Shitje e pjesës takuese banesë e përbashkët ndodhur në lagjen “****”, Berat, të pasurisë nr. ***, sip. 82m² dhe nr. ***, sip. 57m², në shumën 1,700,000 lekë.

Lidhur me vlerën e pasurisë apartament

2.45 Komisioni hetoi lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Fierit. Bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 20.8.2008, të Këshillit të Ministrave, rezultoi se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Fierit është në vlerën 55,062 lekë/m². Sipërfaqja e ndërtimit të apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është 140 m² + 15 m² (sipërfaqe të përbashkëta) dhe kostoja llogaritet në vlerën (140 + 15 x 55,062) prej 8,534,610 lekësh. Subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4,650,000 lekë, pra më pak se vlera e tregut.

2.46 Komisioni kërkoi pranë ASHK-së lidhur me kontrata të ngjashme në objektin ndërtimor, ku subjekti i rivlerësimit ka blerë këtë pasuri. ASHK-ja ka dërguar¹² kopje të kontratave të ngjashme, ku rezultuan disa kontrata për pasuritë:

- apartament me sip. 155 m², në vlerën 5,300,000 lekë, shitur më 16.5.2012;
- apartament me sip. 153 m², në vlerën 60,000 euro, shitur më 14.1.2012;
- apartament me sip. 139 m², në vlerën 7,600,000 lekë, shitur më 15.3.2011;
- apartament me sip. 153 m², në vlerën 5,300,000 lekë, shitur më 20.8.2012;
- apartament me sip. 167 m², në vlerën 5,800,000 lekë, shitur më 17.5.2012;
- apartament me sip. 153 m², në vlerën 4,000,000 lekë, shitur më 30.1.2012;
- apartament me sip. 153 m², në vlerën 5,300,000 lekë, shitur më 29.2.2012;
- apartament me sip. 152 m², në vlerën 9,200,000 lekë, shitur më 29.3.2011;
- apartament me sip. 140 m², në vlerën 6,500,000 lekë, shitur më 13.5.2011;
- apartament me sip. 140 m², në vlerën 6,000,000 lekë, shitur më 15.8.2012.

2.47 Nga përgjigjja e ASHK-së Fier rezultuan vlera të ndryshme të shitjeve të apartamenteve në objektin ndërtimor, ku subjekti i rivlerësimit ka blerë pasurinë apartament me sip. 140 m²+15 m², në vlerën 4,650,000 lekë. Vlerat për tipologjinë e përafërt të apartamentit dhe sipërfaqes ndërtimore variojnë nga 4,000,000 lekë deri në 9,200,000 lekë.

¹²Shihni përgjigjen e ASHK-së Fier në dosjen e Komisionit.

2.48 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës nuk ka hetuar asnjë procedim penal ndaj ortakut të shoqërisë “***” sh.p.k., z. Y.I, dhe as ndaj administratorit A. Ç.

2.49 Sipas kontratës për shitjen e sendit në të ardhmen¹³, subjekti i rivlerësimit ka marrë apartamentin në shtator të vitit 2009. Sipas deklarimeve të tij në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka filluar të jetojë në atë apartament në vitin 2010. Dukej se subjekti i rivlerësimit ka marrë trajtim preferencial duke banuar në apartament për 3 vjet e gjysmë dhe duke paguar vetëm 100,000 lekë (sipas kontratës për shitjen e sendit në të ardhmen) përpara se të paguante për të gjithë shumën prej 4,650,000 lekësh.

2.50 Rezultoi gjithashtu se subjekti nuk ka respektuar dispozitat e kontratës për shitjen e sendit në të ardhmen të vitit 2009 për të paguar këstet sipas përcaktimeve të bëra nga vetë palët në këtë kontratë.

2.51 Në përfundim të hetimit nga Komisioni, për këtë pasuri u konstatua:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për krijimin e të gjithë shumës prej 1,700,000 lekësh nga prindërit e subjektit, shumë e cila ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të apartamentit me sip. 140 m².

- Mungesa e të ardhurave të ligjshme në vlerën 1,650,000 lekë për pagesën e këstit të banesës në vitin 2013.

- Dyshime për deklaratë noteriale fiktive ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe prindërve, pasi nuk rezultoi: asnjë transaksion i gjurmueshëm; pagesa është bërë *cash*; pronësia nuk iu kalua asnjëherë prindërve të tij; babai nuk kishte të ardhura të ligjshme për shumën 1,700,000 lekë; dhe pjesa e transferuar e subjektit të rivlerësimit duket të jetë më e lartë se vlera e tregut.

- Trajtim preferencial në dukje (subjekti i rivlerësimit ka jetuar në apartament për 3 vjet e gjysmë përpara se të paguante çmimin e plotë, mund të duket se ka dallime në afatin e dhënies së kësteve midis dy kontratave, çmimi i paguar i apartamentit është më i lartë se ai i tregut).

- Duket se subjekti ka përfituar kredinë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane: i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.52 Për të gjitha gjetjet e mësipërme Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.53 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti, në mënyrë të përmbledhur, parashtrroi: “Nga ana e Komisionit nuk janë marrë në analizë të gjitha të ardhurat e prindërve.

*Këshilli Kombëtar i Restaurimit ka licencuar babain tim Sh me licencën përkatëse ***, datë 26.4.2007, në kategorinë A ‘Projektim dhe zbatim në restaurimin e monumenteve të*

¹³Shihni kontratën nr. ***, datë 17.9.2009, në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

arkitekturës'. Për shkak të këtij profesioni të veçantë, babai im, edhe pse në pension, ka vazhduar të punojë deri në vitet e fundit të jetës së tij.

Ai është angazhuar si pranë kompanive private, por edhe pranë institucioneve publike. Për shkak të kohës së gjatë dhe vdekjes së babait kam mundur të siguroj dokumentacion vetëm për shoqërinë tregtare '***' sh.p.k. Kjo shoqëri me vërtetimin e datës 30.11.2022 ka sqaruar se Sh. M ka qenë i pajisur me licencë profesionale dhe ka ofruar shërbim për shoqërinë '***'. Për këtë periudhë kohore ai ka qenë pensionist dhe përfitonte pension nga kontributet e paguara gjatë periudhës së punës. Për këtë arsye nuk mund të pasqyrohej në listëpagesa për efekt të sigurimeve shoqërore. Meqenëse nuk mund të deklarohej në listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, për z. Sh.M është mbajtur vetëm tatimi mbi të ardhurat personale. Tatimi 10% mbi të ardhurat personale, i mbajtur në burim për këtë person, është transferuar në buxhetin e shtetit nëpërmjet deklaratës përmbledhëse të tatimit të mbajtur në burim.

Po kështu, rezulton se në periudhën 1998 - 1999 është përfshirë pranë Zyrës së Punës si specialist i punëve publike. Kjo zyrë më shkresën e datës 1.12.2022 konfirmon angazhimin e babait tim Sh.M pranë kësaj zyre si specialist i punëve publike për periudhën 1998 – 1999, duke paraqitur edhe situacionet e punimeve për disa rrugë ku ka firmosur në cilësinë e specialistit të punëve publike.

Këto fakte janë mëse të mjaftueshme për të provuar se babai ka krijuar të ardhura të tjera të ligjshme përveç pensionit të pleqërisë.

Në analizën financiare, gjithashtu, nuk janë përfshirë edhe të ardhurat e përfituara nga nëna P. M., për shitjen e pasurisë objekt dhe truall në vitin 1996, në vlerën 500,000 lekë.

Çmimi i blerjes së banesës ka qenë sipas tregut dhe në të njëjtën mënyrë, si dhe për blerës të tjerë të apartamenteve në këtë pallat nga kjo shoqëri. Çmimi i blerjes është përcaktuar që në kontratën e premtim-shitjes të vitit 2009, ku është parashikuar blerja nëpërmjet kreditimit. Ndryshimi i mënyrës së dhënies së kësteve ka ardhur për shkak të pamundësive të mia financiare, si dhe përpjekjeve për të marrë kredi bankare. Pasi fillimi i veprimeve për të marrë kredi ka qenë viti 2011 dhe kredia është miratuar dhe lëvruar vetëm në vitin 2013.

Në kuptim të ligjit që një marrëdhënie të jetë preferenciale duhet të plotësojë në mënyrë kumulative dy kushte që të jetë pa shpërblim dhe të vijë si pasojë e detyrës. Në rastin konkret, ashtu siç dhe është provuar nga vetë KPK-ja rezulton se marrëdhënia ime me shoqërinë '***' sh.p.k., pronarin apo administratorin e saj ka qenë vetëm marrëdhënie e natyrës juridiko-civile. Në asnjë rast nuk u provua nga vetë KPK-ja që unë, si prokuror, të kem pasur çështje me shoqërinë, pronarin apo administratorin. Kështu, kurrsesi nuk mund të kem pasur trajtim preferencial. Gjithashtu, dua të sjell në vëmendjen tuaj se kjo banesë ndodhet në hapësirën e fugës sizmike të dy plative, ku vendoset pallati dhe kjo sjell atëherë dhe në mënyrë permanente dëmtime jo vetëm të banesës time, por të gjithë seksionit. Lidhur me këtë kam kryer një ekspertim teknik vlerësues, i cili ka analizuar shkaqet teknike dhe ka bërë edhe vlerësimin duke u mbështetur në këta faktorë rrisku. Akt i cili do të gjendet bashkëlidhur.

Lidhur me marrëdhënien brenda familjes, KPK-ja ka konsoliduar tashmë qëndrimin e vet, siç është rasti i subjektit I. P., konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 404, datë 23.6.2021. Vendim tashmë i formës së prerë.

Sa i takon pretendimit se vlera prej 1,700,000 lekësh nuk i korrespondon vlerës së tregut, çmuj se ky është një pretendim pa referencë ligjore. Marrëdhëniet tregtare mbështeten në autonominë e vullnetit të palëve. Nuk ka asnjë normë juridike në legjislacion që kufizon palët në një marrëdhënie tregtare për sa i takon çmimit të shitjes të një sendi qoftë të luajtshme apo të paluajtshme. Çmimi është marrëveshje palësh që varen nga shumë faktorë që mund të jenë prezent në momentin e marrëveshjes.

*Për sa i takon faktit se deklarata noteriale nr. ***, datë 1.2.2013, nuk është regjistruar në ZVRPP/Berat shpjegoj se prindërit nuk kanë shkuar për ta regjistruar, por në vitin 2016 kanë lëshuar një deklaratë noteriale ku kanë sqaruar këtë fakt. Kjo deklaratë, pra nr. ***, datë 18.4.2016, hartuar para noteres F. Z., Fier, është depozituar pranë ILDKPKI-së që në vitin 2016.*

*Në vitin 2019 është ndarë nga jeta babai im Sh dhe duke u nisur nga fakti i mosdepozitimit në ZVRPP të deklaratës noteriale nr. ***, datë 1.2.2013, kam depozituar aktet për çelje trashëgimie. Ndër të tjera, kam depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 1.2.2013, për t'u përjashtuar nga trashëgimia. Nga ana e noteres është lëshuar vërtetimi i datës 1.12.2022, ku konfirmon faktin e mësipërm.*

Lidhur me kredinë shprehem se Bashkia kishte programe sociale për të trajtuar banoret e vet, të cilët nuk posedonin banesë, pra ishin të pastrehë. Familja ime në Fier ishte e pastrehë. Kemi aplikuar pranë Bashkisë për trajtimin si të pastrehë. Këshilli Bashkiak, pasi ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin, i ka gjetur ato në pajtim me ligjin dhe ka miratuar kërkesën duke më përfshirë në listat e të pastrehëve. Nëse kërkesa ime nuk do të plotësonte kriteret, pa diskutim Këshilli Bashkiak, si organ kolegjal kompetent, do ta kishte refuzuar atë. Kredia më është miratuar dhe disbursuar në vitin 2013”.

2.54 Vlerësimi i Komisionit

Lidhur me mundësitë e prindërve për dhënien e shumës 1,700,000 lekë pas marrjes në analizë të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vlerëson se:

- Rezultoi se babai i subjektit është pajisur me licencë si drejtues teknik pranë shoqërisë “****”. Kjo shoqëri, me vërtetimin e datës 30.11.2022, ka sqaruar se z. Sh. M ka ofruar shërbim për këtë shoqëri në fushën e konsulencës për ndërhyrje dhe konservimet e objekteve të trashëgimisë kulturore, për periudhën shtator 2007 – nëntor 2012. Për shërbimin e kryer është deklaruar se është paguar dhe është mbajtur vetëm tatimi mbi të ardhurat personale. Tatimi 10% mbi të ardhurat personale, i mbajtur në burim për këtë person, është transferuar në buxhetin e shtetit nëpërmjet deklaratës përmbledhëse të tatimit të mbajtur në burim. Ky sqarim ka ngelur vetëm në kuadrin deklarativ dhe nuk është shoqëruar me ndonjë dokumentacion shkresor provues lëshuar nga institucionet publike përgjegjëse. Në mungesë të provueshmërisë së plotë lidhur me të ardhurat e ligjshme të pretenduara të përfituara nga babai i subjektit, trupi gjykues konkludoi se këto të ardhura

nuk mund të përfshihen në analizën financiare, pasi nuk u krijua bindja lidhur me mundësitë e prindërve për krijimin e këtyre vlerave financiare nga burime të ligjshme.

- Rezultoi se me kontratën noteriale të datës 13.2.1995, notere E. H., Dhoma e Noterisë Berat, nëna e subjektit P. M. ka blerë nga ish Ndërmarrje Komunale Banesa një objekt dhe truall. Ky objekt ndërtimor dhe trualli është shitur në vitin 1996 tek shtetasi B. D., për çmimin 500,000 lekë. Shitja është materializuar me kontratën nr. ***, datë 26.12.1996, noterë N.D Berat. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti lidhur me shitjen e kësaj pasurie, trupi gjykues vendosi të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë objekt dhe truall nga nëna e subjektit të rivlerësimit.
- Lidhur me deklarinimin e subjektit dhe pretendimin për të ardhurat e përfituara nga babai i tij në vitin 1998 - 1999 nga Zyra e Punës Berat, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë këto të ardhura. Subjekti nuk arriti të provojë vlerën e të ardhurave të pretenduara dhe as pagimin e detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit mbi këto të ardhura.
- Në përfundim, Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me mundësitë e prindërve të subjektit për krijimin e shumës 1,700,000 lekë, shumë e cila ka shërbyer për pagimin e kështit të parë për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Fierit.

Analiza e mundësisë së dhënies së shumës 1,700,000 lekë nga prindërit e subjektit

Përshkrimi	Vlera
Pension Sh.M 1.5.1993 – 1.2.2013	2,128,027
Pension P. M 31.12.1993 – 1.2.2013	2,604,006
Të ardhura nga shitje pasurie datë 26.12.1996	500,000
Të ardhura totale	5,232,033
Shpenzime jetese 1993 – 1.2.2013	3,495,049
Blerje objekt zyre datë 5.1.1994	5,588
Blerje truall datë 13.2.1995	8,640
Mundësi kursimi 1993 – 2012	1,722,756
Dhënë subjektit 1,700,000 lekë	1,700,000
Mundësi financiare	22,756

- Nga analiza financiare e përfunduar nga Komisioni rezultoi se prindërit e subjektit kishin mundësi financiare nga burime të ligjshme për dhënien e shumës 1,700,000 lekë subjektit të rivlerësimit dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës.

Lidhur me dyshimin për deklaratë noteriale fiktive ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe prindërve, trajtim preferencial në dukje dhe përfitimin e kredisë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane” i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se:

- Subjekti i rivlerësimit, me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 1.2.2013, ka hequr dorë nga pjesa takuese e pasurisë së përbashkët në qytetin e Beratit, duke përfituar për këtë një shumë financiare nga prindërit e tij në vlerën 1,700,000 lekë. Deri më sot nuk rezultuan veprime të kryera nga subjekti dhe prindërit për finalizimin e veprimit juridik të kryer dhe regjistrimin e kësaj pasurie pranë ASHK-së të pjesës takuese të subjektit në emër të prindërve të tij. Për të vlerësuar nëse ky veprim mund të konsiderohet një veprim fiktiv, trupi gjykues analizoi faktin lidhur me qëllimin e kryerjes së veprimit të tillë për të hequr çdo dyshim të arsyeshëm. Në dukje, ky veprim është bërë me qëllim përfitimin e shumës 1,700,000 lekë nga subjekti për pagimin e këstit të parë të apartamentit të blerë në qytetin e Fierit. Prandaj, trup gjykues hetoi dhe vlerësoi mundësitë e prindërve të subjektit për krijimin e kësaj shume (1,700,000 lekë) ku, në përfundim, rezultoi se prindërit kishin mundësi financiare për krijimin e saj. Gjithashtu, rezultoi se me anë të deklaratës noteriale të datës 18.4.2016 prindërit e subjektit kanë deklaruar se nuk kanë kryer veprime pranë ZVRPP-së për kalimin e pjesës takuese të subjektit në emër të tyre për shkak të disa mosmarrëveshjeve që kanë pasur me bashkëpronarin tjetër (djalin e tyre A. M.). Me anë të vërtetimit të datës 1.12.2022, noterja I. Sh. ka vërtetuar se, subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin Sh. M. (babai), ka vënë në dispozicion edhe deklaratën noteriale të datës 1.2.2013 ku theksohet se ai ka hequr dorë nga pjesa takuese e pasurisë në qytetin e Beratit, pasuri e cila i ka kaluar prindërve të tij. Pra, subjekti ka kryer disa veprime për finalizimin e veprimit juridik për heqjen dorë të tij nga pjesa takuese e pasurisë në qytetin e Beratit.

Në përfundim, trupi gjykues konkludon se veprimet e subjektit dhe prindërve të tij nuk kanë qenë veprime fiktive, por veprime juridike të kryera midis tyre për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare:

- Lidhur me trajtimin preferencial, trupi gjykues vlerëson se vullneti i palëve mbi marrëdhënien kontraktore për shitblerjen e pasurisë është shprehur në formën e duhur shkresore (me anë të kontratës së shitjes së sendit në të ardhmen dhe kontratës së shitblerjes). Palët, në të dyja këto kontrata, kanë caktuar çmimin e njëjtë të shitjes së pasurisë apartament me vullnetin e lirë të tyre. Subjekti ka qenë koherent në deklarin e kësaj pasurie dhe burimit të krijimit që nga deklarata periodike, deklarata *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorit. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur asnjë çështje penale me palën shitëse të pasurisë (si për shoqërinë dhe për ortakët e saj). Gjithashtu, në këtë godinë, ku ndodhet pasuria apartament e blerë nga subjekti, ekzistojnë dhe apartamente të tjera të blera nga individë të ndryshëm me vlerë më të vogël se vlera e blerjes nga ana e subjektit.

Në përfundim, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk ekziston ndonjë trajtim preferencial ndaj subjektit apo konflikt interesi me palën shitëse për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Fierit.

- Lidhur me përfitimin e kredisë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, trupi gjykues analizoi faktet dhe vlerësoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka aplikuar pranë Bashkisë Fier për përfitimin e kredisë së butë me

terma lehtësuese. Pas vlerësimit nga bashkia, kërkesa e subjektit së bashku me dokumentacion shoqërues është përcjellë pranë Këshillit Bashkiak Fier, i cili e ka miratuar përfitimin e kredisë.

Bazuar në kredinë bankare datë 25.4.2013 rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar kredi nga BKT-ja në vlerën 2,900,000 lekë. Baza ligjore e përfitimit të kredisë është ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, si dhe VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, të ndryshuar. Sipas kësaj VKM-je, funksionarët publikë (ku përfshihet edhe kategoria e gjyqtarëve dhe prokurorëve) që kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë u lind e drejta të kërkojnë trajtim me kredi, me kushte lehtësuese, nga shteti. Për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës, që, në kuptim të këtij vendimi nënkupton territorin e rrethit, ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën. Sipas këtij vendimi, me nevojën për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, sipas këtij vendimi, do të nënkuptohet rasti kur subjekti nuk disponon ose disponon më pak sipërfaqe banimi se kuota minimale. Vlera e caktuar për përfitimin e kësaj kredie ishte deri në masën 5,000,000 lekë. Sipas kësaj VKM-je, subjektet përfituese nuk duhet të kishin pronësi banesë apo pasuri të tjera që përdoren për veprimtari ekonomike në vendin e ushtrimit të detyrës, etj. Përzgjedhja e përfituesve të kredisë bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuar dhe ndiqen nga strukturat përkatëse shtetërore që shqyrtojnë kërkesat për kredi për strehim.

2.55 Pas vlerësimit të përgjigjeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit, Komisioni hartoi analizën e re financiare lidhur me mundësinë e pagesës së kështit prej 1,650,000 lekësh në vitin 2013, si vijon:

Analiza e mundësisë së pagesës së kështit të apartamentit me vlerë 1,650,000 lekë

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 1.1.13 – 4.2.2013	144,032
Të ardhura bashkëshortja 1.1.2013 – 4.2.2013	40,881
Dhënë nga prindërit e subjektit	1,700,000
Të ardhura totale 1.1.2013 - 4.2.2013	1,884,913
Shpenzime jetese 1.1.2013 - 4.2.2013	47,008
Paguar për apartament në Fier datë 4.2.2013	1,650,000
Shpenzuar në total 1.1.2013 - 4.2.2013	1,697,008
Ndryshim likuiditeti 31.12.2012 – 4.2.2013	73,981
Mundësi financiare	113,923

Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e kështit të apartamentit, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën.

2.56 Konkluzion i Komisionit

- Në përfundim të hetimit administrativ të kryer për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Fierit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk u konstatuan problematika.

3. Automjet tip “****” me targa AA ***

3.1 Subjekti ka deklaruar automjet tip “****”, viti i prodhimit 2001, blerë sipas kontratës së shitblerjes së automjetit datë 11.12.2015. Vlera: 180,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

3.2 Burimi i krijimit: shitja e automjetit tip “****”, viti i prodhimit 1996, datë 11.12.2015 dhe kursimet nga pagat.

Hetimi i Kryer nga Komisioni

3.3 Rezultoi se me kontratën shitblerje automjeti nr. ***, datë 11.12.2015, subjekti dhe bashkëshortja O.M kanë blerë automjetin tip “****”, në shumën 180,000 lekë.

3.4 Bazuar në vërtetimin e DRSHTRR-së Fier¹⁴, subjekti i rivlerësimit ka disponuar automjetet:

- *Ka të regjistruar automjetin tip “****”, me targa AA ***. Gjithashtu është konfirmuar se subjekti ka pasur në pronësi automjetin tip “****”, me targa AA ***, shitur më 11.12.2015;*
- *sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 11.12.2015, bashkëshortja e subjektit O. M ka shitur automjetin tip “****”, në vlerën 80,000 lekë;*
- *sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 20.2.2012, bashkëshortja O. M blen automjetin tip “****”, në vlerën 80,000 lekë;*
- *subjekti ka pasur në pronësi automjetin me targa BR ***, tip “****”, i cili është shitur më 10.11.2009, në vlerën 300,000 lekë;*
- *sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., datë 3.2.2008, subjekti ka blerë automjetin tip “****”, në vlerën 250,000 lekë.*

3.5 Vlerat e shitjes dhe blerjes së automjeteve ndër vite janë reflektuar në analizën financiare sipas viteve përkatëse.

3.6 Komisioni hartoi analizën financiare mbi mundësinë e blerjes së automjetit tip “****”, me targa AA *** nga subjekti dhe bashkëshortja.

Analiza e mundësisë e blerjes së automjetit tip “****” me targa AA ***

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 1.1.2015 - 12.12.2015	1,188,662
Të ardhura bashkëshortja 1.1.2015 - 12.12.2015	607,781
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”	80,000
Të ardhura totale 1.1.2015 - 12.12.2015	1,876,443
Shpenzime jetese 1.1.2015 - 12.12.2015	859,725
Shpenzime për kredi në BKT 1.1.2015 - 12.12.2015	232,101
Shpenzime mobilimi 1.1.2015 - 12.12.2015	89,444
Shpenzime udhëtimi 1.1.2015 - 12.12.2015	250,152
Blerje automjet tip “****” më 12.12.2015	180,000
Shpenzuar në total 1.1.2015 - 12.12.2015	1,611,422
Ndryshim likuiditeti 31.12.2014 - 12.12.2015	74,065

¹⁴Shihni përgjigjet e DPSHTRR-së në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

Mundësi financiare	190,957
---------------------------	----------------

3.7 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja, kishin mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit tip *** me datë 12.12.2015, shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës.

3.8 Si burim për blerjen e automjetit tip *** në datën 12.12.2015 është përfshirë edhe e ardhura nga shitja e automjetit tjetër tip *** me targa AA*** në pronësinë e subjektit. Kjo shitje është bërë sipas kontratës nr. *** Rep. Dhe nr. *** Kol. e datës 11.12.2015, sipas së cilës mjete është shitur në vlerën 80,000 lekë.

3.9 Është analizuar gjithashtu dhe mundësia e blerjes automjetit me targa AA***, sipas kontratës me numër *** Rep. dhe nr. *** Kol. të datës 20.2.2012 meqë të ardhurat nga shitja e tij, kanë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tjetër me targa AA*** në vitin 2015.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “*”, me targa AA *****

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 1.1.2012 - 20.2.2012	136,000
Të ardhura bashkëshortja 1.1.2012 - 20.2.2012	80,796
Të ardhura totale 1.1.2012 - 20.2.2012	216,796
Shpenzime jetese 1.1.2012 - 20.2.2012	93,032
Shpenzime mobilimi 1.1.2012 - 20.2.2013	10,000
Blerje automjet tip “***” më 20.2.2012	80,000
Shpenzuar në total 1.1.2012 - 20.2.2012	183,032
Ndryshim likuiditeti 31.12.2011 - 20.2.2012	15,575
Mundësi financiare	18,189

3.10 Sipas analizës financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin burime të mjaftueshme për blerjen e automjetit, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën.

3.11 Konkluzion i Komisionit

➤ Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri dhe ka pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen automjetit tip “***”, me targa AA ***, me vlerë 180,000 lekë, në vitin 2015.

4. Të tjera

4.1 Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen si garanci të shumave 10,000 euro në vitin 2008 dhe 4,000 euro në vitin 2009 nga shtetasi O.M, me qëllim marrjen e vizës për udhëtim jashtë vendit.

4.2 Lidhur me këtë deklaram subjektit iu kërkua që të provojë mundësitë financiare të shtetasit O.M për dhënien hua të kësaj shume, si dhe veprimet e kryera për kalimin e shumave përkatëse.

4.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti deklaroi se: “Shtetasi O.M është bashkëpronar i shoqërisë “***” me aktivitet tregtar prej vitit 2001, me mundësi të konsiderueshme

financiare, për të provuar bashkëlidhur po ju dërgoj vërtetimin përkatës datë 23.9.2022, së bashku me bilancet e viteve 2008 dhe 2009, si dhe ekstraktin e QKB-së të vitit 2022.

Shumat 10,000 euro dhe 4,000 euro janë dërguar dhe kthyer brenda një afati të shkurtër po nëpërmjet 'Alpha Bank', pa u tërhequr asnjëherë dhe për të provuar kalimin e shumave po ju dërgoj dy mandate urdhërpagese datë 27.6.2008 dhe datë 3.2.2009.

4.4 Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka paraqitur nga “Alpha Bank” mandat urdhërpagesat për kthimin e huas nga llogaria në emër të tij në llogarinë e shtetasit O.M. Konkretisht, mandati në vlerën 10,000 në datën 27.6.2008 me përshkrimin “Sa kaluar nga Genci Mane tek O.M (kthim borxhi)” dhe mandati në vlerën 4,000 euro në datën 3.2.2009, me përshkrim “Sa kaluar nga Genci Mane në favor të O. M kthim borxhi”.

4.5 Sipas faqes zyrtare të QKB-së rezulton se shtetasi O.M është bashkëpronar në shoqërinë private “****” sh.p.k. të themeluar në vitin 2001.

4.6 Sipas pasqyrave financiare të sjella në përgjigje të pyetësorit nr. *** rezulton se kjo shoqëri ka pasur xhiro 190,576,430 lekë në vitin 2008 dhe 71,867,594 lekë në vitin 2009.

4.7 Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e përcjellë në përgjigje të pyetësorit lidhur me shumat e dhëna hua nga shtetasi O.M dhe konstatoi se deklaratimet e subjektit rezultuan të sakta.

4.8 Bazuar në sistemin *TIMS* rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar në korrik të vitit 2008 në Itali dhe në shkurt të vitit 2009 në Londër (periudha e deklaruar e përfitimit të huave për pajisjen me vizë).

4.9 Shumat e përfituara nga subjekti kanë qenë në një periudhë kohe të shkurtër dhe brenda vitit provuar nga veprimet e kryera pranë “Alpha Bank”. Subjekti nuk ka përfituar nga këto shuma financiare, por i ka disponuar pa i përdorur për një periudhë të shkurtër kohore si garanci e kërkuar dhe më pas i janë kthyer huadhënësit me rrugë bankare. Nuk kanë ndikuar në analizën financiare marrja dhe kthimi i këtyre shumave, pasi veprimet duket se janë kthyer brenda vitit.

4.10 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk rezultoi që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të shtetasit O.M.

4.11 Konkluzion i Komisionit

➤ Në përfundim nuk u konstatuan problematika lidhur me këto dy hua të dhëna nga shtetasi O.M për subjektin e rivlerësimit në vitet 2008 - 2009.

5. Analiza financiare

5.1 Analiza financiare e subjektit Genci Mane fillon në vitin 2001 deri në fund të vitit 2016.

5.2 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka një pamjaftueshmëri financiare totale në vlerën 1,259,775 lekë (pamundësi e gjitha në vitin 2013) për periudhën 2001 – 2016.

5.3 Në vitin 2013 nuk u përfshinë në analizën financiare të ardhurat nga heqja dorë nga subjekti të ¼ pjesë takuese të banesës së përbashkët me sip. 82 m² në Berat, për shkak se nuk

u provua plotësisht mundësia financiare e prindërve për krijimin me burime të ligjshme të shumës së dhënë prej 1,700,000 lekësh.

5.4 Për pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.5 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi se pamundësia financiare e konstatuar nga Komisioni ka ardhur vetëm si rezultat i mospërfshirjes në këtë analizë të të ardhurave të prindërve të subjektit dhe mundësisë së tyre për krijimin e shumës 1,700,000 lekë dhënë subjektit të rivlerësimit (shumë e cila është përdorur për pagimin e këstit të parë për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Fierit).

Vlerësimi i Komisionit

5.6 Komisioni, lidhur me mundësinë e prindërve për krijimin e shumës 1,700,000 lekë, e ka analizuar dhe vlerësuar në pikën 2 këtij vendimi, ku në përfundim rezultoi mundësia financiare e tyre për krijimin e kësaj shume.

5.7 Si përfundim Komisioni hartoi analizën financiare për subjektin e rivlerësimit për periudhën 2001 – 2016, paraqitur në tabelën si vijon:

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: GENCI SH. MANE																
	2001-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	0	0	271	-151,169	169,504	29,598	220,824	78,594	11,906	-24,693	104,771	4,547,542	-1,409	199,065	-17,565	5,160,000
Banese 82 m2 + verande & oborr 57,2 L. *** Berat - 25%																0
Banese 140 m2 L. ***, Fier + 15 m2 sip. Perbashket - 50%								100,000				4,550,000				4,650,000
Automjet tip **** - ****- 50% - 2008						250,000										250,000
Automjet tip **** - ****- 2012 - 50%											80,000					80,000
Automjet tip *** - ****- 50% - 2015														180,000		180,000
Ndryshim ne likuiditet		0	271	-151,169	169,504	29,598	-29,176	-21,406	11,906	-24,693	24,771	-2,458	-1,409	19,065	-17,565	
DETYRIME	0	0	0	267,504	-143,702	-123,801	0	0	0	0	0	2,813,455	-158,164	-162,331	-167,753	2,325,207
Kredi konsumatore Raiffeisen Bank - O. M. - 300,000 leke - 2005				267,504	-143,702	-123,801										0
Kredi BKT - 2,900,000 leke - 2013												2,813,455	-158,164	-162,331	-167,753	2,325,207
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	0	0	271	-418,673	313,207	153,399	220,824	78,594	11,906	-24,693	104,771	1,734,088	156,755	361,396	150,187	2,834,793
TE ARDHURA dokumentuar	937,302	694,157	723,823	991,415	1,110,008	1,210,977	1,206,372	1,291,227	1,292,526	1,446,565	1,387,437	3,119,110	1,725,376	1,887,378	1,907,593	20,931,266
Te ardhura nga pagat subjekti Genci Mane	665,460	506,118	530,015	767,148	844,135	898,001	847,352	863,216	839,772	945,029	900,011	920,975	1,165,698	1,199,385	1,298,107	13,190,423
Te ardhura nga pagat bashkeshortja O. M.	271,842	188,039	193,808	224,267	265,873	312,976	359,020	428,011	452,754	501,536	487,426	498,135	559,678	607,993	609,486	5,960,844
Te ardhura nga shitje automjeti **** - 2015														80,000		80,000
Te ardhura nga shitja 1/4 e apartamentit ne Berat prinderve - 2013												1,700,000				1,700,000
SHPENZIME	684,388	331,892	410,195	799,799	470,793	554,879	736,181	1,074,448	880,588	746,678	837,527	944,798	1,152,252	1,330,496	1,309,077	12,263,989
Shpenzime jetese	584,388	281,892	360,195	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	8,675,083
Taksa mbi kalimin e pronesise												48,900				48,900
Shpenzim punime dhe mobilim banese L. ****, Berat	100,000	50,000	50,000	350,000												550,000
Shpenzim mobilim banese L. ****, Fier								150,000	230,000	140,000	60,000	140,000	93,333	93,333	93,333	1,000,000
Shpenzime arsimimi per femijet															32,000	32,000
Shpenzime interesi kredi 300,000 leke Raiffeisen Bank				11,571	32,565	8,399										52,534
Shpenzime interesi dhe komisione kredi BKT												93,655	94,861	89,906	85,019	363,441
Shpenzime udhetime			0	0	0	0	189,701	377,968	104,108	60,198	219,335	98,147	84,066	250,152	158,356	1,542,031
Analiza dokumentuar	252,914	362,265	313,357	610,290	326,008	502,699	249,367	138,185	400,033	724,580	445,138	440,225	416,369	195,487	448,329	5,572,331
													Pamundesia financiare 2001 - 2016			0

Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkeshortja e tij kishin burime të mjaftueshme për shtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën e rivlerësimit.

6. Metodologjia

Gjatë kësaj analize financiare, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga “Raiffeisen Bank”, “Alpha Bank” dhe “Credins Bank”.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

- i. të ardhurat nga pagat e subjektit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (2001 – 2005) sipas shkresës nr. *** prot., datë 24.10.2016 dhe në Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (2005 – 2016);
- ii. të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit në shkollën “****”, Berat (2001 – 2007), shkolla “****”, Berat (2008 – 2011) dhe shkollën “****”, Fier (2011 – 2016);
- iii. të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”, me targa AA *** (2015);
- iv. të ardhurat nga heqja dorë nga subjekti i ¼ pjesë takuese të banesës së përbashkët me sip. 82 m² në Berat, në favor të prindërve të tij (2013).

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i. shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i);
- ii. shpenzimet për kalimin e të drejtës së pronësisë për apartamentin në Fier (2013);
- iii. shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS* – për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019(JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;
- iv. shpenzimet për punime dhe mobilim banese në lagjen “****”, Berat (2001 – 2005), si dhe shpenzimet për mobilim të banesës në lagjen “****”, Fier (2009 – 2016), sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje pyetësores;
- v. shpenzimet e arsimimit për fëmijët (2016);
- vi. shpenzimet për interesa të kredisë 300,000 lekë të marrë në “Raiffeisen Bank” (2005 – 2007);
- vii. shpenzimet për interesa të kredisë 2,900,000 lekë të marrë në BKT (2013 – 2016).

d. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e premtimit dhe shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁵.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, DSIK-ja, pas verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. *** prot., datë

¹⁵Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 19.9.2022, të KDZH-së, ku rezulton se:

- Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimin të organizuar.
- Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Genci Mane është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Për pastërtinë e figurës nuk ka pasur të dhëna e dyshime bazuar në raportin e parë të DSIK-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2022, iu kërkua DSIK-së përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës për subjektin Genci Mane.

Në datën 27.9.2022 është paraqitur raporti i deklasifikuar i DSIK-së (nr. ***, datë 19.9.2022), ku konstatohet papërshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Genci Mane.

Sipas DSIK-së dyshohet se subjekti është përfshirë në veprimtari korruptive, të kundërligjshme dhe të dhëna që disponohen për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Lidhur me vlerësimin e figurës Komisioni bëri disa hetime nisur dhe nga *indiciet e marra për subjektin e rivlerësimit.*

1. Bazuar në sistemin *TIMS* rezultoi se subjekti ka dalë jashtë vendit me automjetet me targa: AA ***, në pronësi të shtetasit R. Ç.; AA ***, në pronësi të shtetasit M. R.; AA ***, në pronësi të shtetasit M. Xh.; dhe FR ***, në pronësi të shtetasit E. M.

Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar përdorimin e këtyre automjeteve dhe se marrëdhëniet me këta persona kanë qenë shoqërore (shihni përgjigjen e subjektit në pyetësorin nr. ***).

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2022, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar apo ndjekur ndonjë procedim penal me personat pronarë të pasurive automjet që subjekti i rivlerësimit ka përdorur në periudha të ndryshme.

Me shkresën *** prot., datë 7.11.2022, është kërkuar informacion pranë SPAK-ut lidhur me ndonjë çështje penale të mundshme ndaj shtetasve R. Ç. dhe M. R. SPAK, me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2022, ka kthyer përgjigje ku informon se ndaj këtyre dy shtetasve nuk figuron të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Pra, sa më sipër, nuk rezultuan që këto persona të kenë pasur veprimtari kriminale apo të jenë përfshirë në krimin e organizuar.

Në përfundim nuk u konstatuan kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe se subjekti nuk ka ndjekur ndonjë procedim penal ndaj këtyre personave që ka pasur marrëdhënie shoqërore.

2. Bazuar nga *indiciet* e marra nga Komisioni u hetua lidhur me përdorimin e automjeteve me targa AA *** dhe AA ***. Për të dhënat e këtyre mjeteve u kërkua informacion edhe në AMF, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2022, ka paraqitur informacion lidhur me mbulimin me sigurim të këtyre mjeteve motorike. Rezultoi se pronar dhe përdorues të këtyre mjeteve janë përkatësisht shtetasit R. Ç. dhe M. R. Subjekti i rivlerësimit rezultoi si policëmbajtës për pasurinë automjet me targa AA***, së bashku me pronarin dhe përdoruesin e mjetit shtetasin R. Ç.

3. Bazuar në *indiciet* e marra nga Komisioni u hetua lidhur me kontakte të mundshme apo ndjekje të çështjeve penale nga subjekti i rivlerësimit me personat A.I, V.M, A. K dhe F.M.

Për të konstatuar nëse subjekti i rivlerësimit ka ndjekur ndonjë procedim penal lidhur me këto shtetas, iu kërkua informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2022, A. GJ., ka kthyer përgjigje duke informuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur nën hetim këta shtetas.

Nga hetimi i kryer nuk u konstatuan problematika lidhur me subjektin e rivlerësimit që lidhen me shtetasit A. I., V. M., A. K. dhe F. M.

Gjithashtu, me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk rezultuan procedime penale ndaj shtetasve M.R, B. R, O.M dhe R.Ç. Për shtetasin A.K rezultoi se është bërë njohje e vendimit penal të Gjykatës së Milanos, Itali. Subjekti i rivlerësimit për këtë shtetas duket se ka ndjekur çështjen gjyqësore për zëvendësimin e masës mjekësore, kërkuar nga ky shtetas. Prokuroria ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së shtetasit A.K dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 6.3.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit A. K.

4. Bazuar në *indiciet* e marra nga Komisioni u hetua lidhur me përdorimin e mundshëm të numrave telefonikë nga subjekti i rivlerësimit (nr. ***).

Për të mundësuar informacion lidhur me përdorimin e telefonisë mobile nga subjekti, iu kërkua informacion kompanive *** dhe ***.

Kompania telefonike ***, me shkresën e datës 8.8.2022 ka kthyer përgjigje, ku konfirmon se për shtetasin Genci Mane korrespondojnë numrat celularë:

- *** aktiv që nga data 21.6.2008;
- *** aktiv që nga data 5.4.2014;
- *** inaktiv nga data 17.1.2018.

Kompania telefonike ***, me shkresën e datës 27.7.2022 ka kthyer përgjigje, ku ka konfirmuar se shtetasi Genci Mane nuk ka numër aktiv pranë kësaj kompanie, por ka përdorur numrin *** deri në datën 5.8.2009.

Në përfundim të hetimit nuk u konstatua që subjekti i rivlerësimit të këtë pasur në përdorim numrin e celularit ***.

5. Bazuar në *indiciet* e marra nga Komisioni u hetua lidhur me përdorimin brenda vendit të automjeteve me targa AA *** dhe AA *** dhe kundërvajtjet administrative të mundshme ndaj këtyre mjeteve dhe personat përdorues. Për këtë iu dërguar shkresë Drejtorisë së Policisë së Shtetit.

DPSH-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2022, ka dërguar informacionin e kërkuar, ku rezultoi:

- Automjeti me targa AA *** ka gjithsej 5 masa administrative për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Pronar i këtij automjeti rezulton shtetasi A.K. Nuk u konstatua marrja e ndonjë mase administrative ndaj subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur si përdorues i këtij mjeti.
- Automjeti me targa AA *** ka gjithsej 11 masa administrative. Pronar i këtij automjeti rezulton shtetasi R.Ç. Për këtë mjet rezulton se bashkëshortja e subjektit O.M ka marrë masë administrative si përdoruese e tij në datën 1.8.2021 në vlerën 1,000 lekë.

6. Bazuar në *indiciet* e marra nga Komisioni u hetua edhe për lëvizjet e subjektit dhe personave të lidhur jashtë vendit. Për këtë iu kërkua Drejtorisë së Policisë së Shtetit të dhëna për hyrje-daljet jashtë vendit. DPSH-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2022, ka dërguar pranë Komisionit të dhënat e kërkuara për subjektin e rivlerësimit.

Nga verifikimi i sistemit *TIMS* lidhur me hyrje-daljet e subjektit jashtë vendit nuk u konstatuan problematika. Subjekti kryesisht rezultoi se ka dalë jashtë vendit me familjen dhe në raste të tjera me personat dhe automjetet e deklaruara në përgjigje të pyetësorit standard.

Bazuar në faktet e sipërpërmendura dhe provat e mbledhura, Komisioni konstatoi se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontakte të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- ii. Për subjektin e rivlerësimit nuk u konstatuan përfshirjen e tij në veprimtari korruptive dhe të kundërligjshme.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën e kontrollit të figurës sipas ligjit.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional të subjektit Genci Mane është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara, duke iu referuar kritereve të të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, etj.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se:

- Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Subjekti i rivlerësimit Genci Mane për periudhën maj 2005 dhe deri aktualisht ushtron funksionet e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
- Për sa iu përket të dhënave statistikore, prokurori Genci Mane ka deklaruar se gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 të ushtrimit të detyrës ka trajtuar gjithsej 496 procedime penale, nga të cilat 248 dërguar për gjykim.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurori Genci Mane, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, si vijon:

- i. dokumenti ligjor “Diskutim përfundimtar”, për procedimin penal nr. *** të vitit 2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- ii. dokumenti ligjor “Diskutim përfundimtar”, për procedimin penal nr. *** të vitit 2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- iii. dokumenti ligjor “Diskutim përfundimtar”, për procedimin penal nr. *** të vitit 2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me këto tri çështje të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk u konstatuan problematika.

Pesë dosjet e përzgjedhura me short

Dosja 1

Kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 2.3.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Dokumenti ligjor – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 25.3.2016, për kallëzimin penal nr. ***, datë 2.3.2016, për veprën penale “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

Rrethanat e faktit

Shtetasi J.B ka paraqitur ankim për ngjarjen e datës 28.2.2016, ku në vendin e quajtur fshati M në Njësinë Administrative F, pasi ka debatuar dhe drejtuar fyerje ndaj njëritjetrit me shtetasin P.T, ky i fundit e ka goditur me një send biçak në pjesën e shpatullës. Sipas ankuesit, konflikti i mësipërm ka nisur në lidhje me debatin e zhvilluar midis babait të tij S.B dhe shtetasve J.T dhe P. T.

Sipas aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 29.2.2016, mbi ekzaminimin e shtetasit J.B rezulton se konstatohet një plagë në pjesën e poshtme të kurrizit nga ana e majtë sipër belit, 1 cm e gjatë.

Nga shpjegimet e shtetasve J.B dhe P.T provohet fakti se ata janë konfliktuar me njëritjetrin dhe se ky i fundit ka shpjeguar se i janë drejtuar fjalë kanosëse nga shtetasi J.B.

Në këto kushte, subjekti ka konstatuar se nuk rezulton të ndodhemi përpara veprës penale “kanosje”, të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, pasi mungon ana objektive e kësaj vepre, konkretisht nuk ka veprime për një kanosje serioze për vrasje apo plagosje të rëndë, e cila nuk do të linte asnjë dyshim se do të realizohej.

Sa më sipër, rezulton të ndodhemi përpara elementeve të veprave penale “dëmtime të tjera me dashje” dhe “fyerje”, parashikuara nga nenet 90/2 dhe 119 të Kodit Penal.

Sipas nenit 59 të Kodit Penal, i dëmtuari nga vepra penale e parashikuar nga nenet 90/2 dhe 119 të këtij Kodi ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë.

Në mbështetje të nenit 290/1, germa “e” e Kodit të Procedurës Penale, në datën 25.3.2016 subjekti i rivlerësimit, prokurori Genci Mane, ka vendosur:

- i. Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 2.3.2016, për shkak se çështja ndiqet drejtpërsëdrejti në gjykatë.
- ii. Vendimi t’u njoftohet të interesuarve.
- iii. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë brenda afatit 30-ditor i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm.

Dosja 2

Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 20.11.2014, për veprën penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në ngarkim të shtetasit E.D.

Rrethanat e faktit

Në datën 19.11.2014, rreth orës 21:00, në vendin e quajtur Kryqëzimi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier, oficerët e policisë gjyqësore A. K., A. P., G. F., K. M., K. T. dhe G. Sh kanë ndaluar automjetin me targa AA ***, që drejtohej nga shtetasi E.D. Në brendësi të automjetit ndodhej drejtuesi i automjetit dhe në vendin e pasagjerit ndodhej shtetasi L.K.

Nga kontrolli personal i drejtuesit të automjetit, shtetasit E.D, ka rezultuar se xhepin e krahut të majtë të xhupit që kishte veshur është konstatuar një paketë duhani e markës “****” me ngjyrë të bardhë. Në brendësi të paketës së duhanit është konstatuar materiali bimor në formë hoçeje me ngjyrë jeshile, i ngjashëm me materialin bimor lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*.

Nga peshimi i materialit bimor që i është sekuestruar shtetasit E.D rezulton se ky material bimor ka një peshë prej 8.55 gram me gjithë ambalazh dhe 1.45 gram pa ambalazh.

Sipas aktekspertimit kimik nr. ***, datë 15.1.2015, rezulton se pesha e materialit bimor pa ambalazh është 1.454 gram dhe se materiali bimor është *cannabis*, produkt herbal i bimës *cannabis sativa*.

Sipas aktekspertimit toksikologjik nr. ***, datë 30.11.2014, në mostrën e marrë shtetasit E.D u zbulua në nivel gjurme prania e produkteve të kanabinoidëve të metabolizmit të bimës *cannabis sativa* në organizmin e njeriut.

Sipas aktekspertimit mjeko-ligjor (toksikologjik) nr. ***, viti 2015, rezulton se sasia prej 1.424 gram e lëndës narkotike *cannabis sativa* me praninë THC të rastit në vlerën 20.2% ose e konvertuar në miligram e barabartë me 29.3 mg, që i është sekuestruar shtetasit E.D, konsiderohet “dozë për përdorim vetjak” jo i dëmshëm. Sasia prej 1.454 gram *cannabis* sekuestruar shtetasit të mësipërm me karakteristikat sipas aktekspertimit kimik është brenda aftësive fiziko-biologjike të shtetasit E.D dhe brenda tolerancës që paraqet organizmi i tij dhe, si i tillë, përdorimi i kësaj sasive si një e tërë nuk krijon tek ky shtetas efekte të tilla të asaj shkalle që do të dëmtonte shëndetin e tij.

Nga shpjegimet e personit nën hetim E.D rezulton se ka gjetur lëndën narkotike të mësipërme dhe se është përdorues i saj.

Sipas akteve të mësipërme mjeko-ligjore rezulton se personi nën hetim është përdorues i lëndëve narkotike dhe lënda e mësipërme konsiderohet “dozë për përdorim vetjak” jo i dëmshëm.

Në analizë të veprimeve hetimore të mësipërme rezulton se jemi përpara rastit të përdorimit vetjak me doza të vogla të bimës narkotike të gjetur personit nën hetim E.D.

Me vendimin datë 15.5.2015, subjekti Genci Mane, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në bazë të nenit 328, germa “b”, 2611/a dhe nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur:

- i. Pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 20.11.2014, për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal në ngarkim të personit nën hetim E.D.
- ii. Shuarjen e masës së sigurimit të detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, caktuar personit nën hetim E. D, sipas vendimit nr. ***, datë 10.2.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë.
- iii. Të njohë me këtë vendim shtetasin E.D dhe OPGJ-në A.K pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier.
- iv. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivi.

Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes. Baza ligjore e vendimit të pushimit të procedimit penal është identifikuar drejt.

Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit Genci Mane, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Me shkresën datë 6.7.2015, vendimi i është komunikuar palëve.

Dosja 3

Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 9.12.2015, për kryerjen e veprës penale “shkatërrim të pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal.

Rrethanat e faktit

Në datën 6.12.2015, rreth orës 3:00, është konstatuar se pranë banesës së shtetasit V.B, në F.Ç, Fier, po digjeshin dy automjete në pronësi të tij.

Nga këqyrja e vendit të ngjarjes ka rezultuar se dy automjetet ishin të vendosura pranë në distancë rreth 30 cm.

Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2016, të Drejtorisë së Shërbimit të MNSH-së pranë Bashkisë Fier është dërguar aktekspertimi teknik-zjarri nr. ***, datë 19.2.2016, sipas të cilit është konkluduar se:

- Vatra fillestare e zjarrit është tek automjeti tip “****” dhe konkretisht në baterinë e këtij mjeti.
- Dyshohet se shkak i rënies së zjarrit mund të ketë qenë shkëndija elektrike nga një masë në bateri.

I pyetur si deklarues, shtetasi V. B ka shpjeguar se ka në pronësi këto dy automjete. Në datën 5.12.2015, rreth orës 20:00, ka mbyllur makinën në pjesën e pasme të banesës. Rreth orës 3:00 të datës 6.12.2015 ka ndjerë zhurmë sikur po kërciste diçka, është ngritur dhe ka dalë jashtë për të kontrolluar se nga vinte zhurma ku ka konstatuar mjetet e tij që ishin në flakë. Sipas tij, xhipi kishte marrë më shume flakë, e cila po përhapej edhe në automjetin tip “****”, i cili ishte e parkuar pranë xhipit.

Deklaruesi shpjegon se nuk ka konflikt me asnjë person. Nuk ka asnjë dyshim tek ndonjë person pasi automjetet i ka blerë të rregullta dhe nuk ka pasur probleme me personat të cilët ka blerë automjetet. Ai shprehet se konflikte të tjera nuk ka dhe nuk e di se kush mund të jenë personat e mundshëm që kanë kryer këtë veprë penale.

Në analizë të veprimeve hetimore nuk rezulton të jemi përpara dëmtimit me dashje të pronës me zjarr, pasi siç rezulton nga këqyrja e vendit të ngjarjes, aktekspertimi teknik-zjarri dhe deklaramet e shtetasve të mësipërm, jemi përpara faktorëve të cilët kanë të bëjnë me masë elektrike në bateri dhe nuk ka faktorë të tjerë të jashtëm të cilët kanë shkaktuar rënien e zjarrit në mjetet e mësipërme.

Në këto kushte, nga kryerja e veprimeve hetimore nuk rezulton të jemi përpara konsumimit të elementeve të veprës penale “shkatërrim të pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal dhe gjithashtu nuk jemi përpara ndonjë veprë tjetër penale.

Me vendimin datë 6.6.2016 subjekti Genci Mane, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në bazë të nenit 328, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “Pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 9.12.2015, për veprën penale ‘shkatërrim të pronës me zjarr’, të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal”.

Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes. Baza ligjore e vendimit të pushimit të procedimit penal është identifikuar drejt.

Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes të palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit Genci Mane, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Me shkresën datë 14.6.2016, vendimi i është komunikuar palëve.

Dosja 4

Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 9.10.2013, me të pandehur shtetasin Sh.K, akuzuar për veprat penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 79/dh-22 e 25 dhe 278/4 të Kodit Penal dhe shtetasin A.M, akuzuar për veprën penale “vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/dh-22 dhe 25 të Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 28.5.2014.

Rrethanat e faktit

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se në datën 7.10.2013, rreth orës 23:00, në aksin rrugor Fier-Patos, shtetasit E.S dhe E.S, ndërsa udhëtonin me automjet janë goditur me armë zjarri nga automjeti me të cilin udhëtonin të pandehurit Sh.K dhe A.M, me të cilët janë konfliktuar disa minuta më parë në një lokal në lagjen “****” te vendi i quajtur ***, Fier. Goditja me armë zjarri e këtyre shtetasve është bërë për shkak të konfliktit që ata kanë pasur midis tyre në lokalin e shtetasës Z.B, ndodhur në lagjen “****”, Fier.

Janë kryer veprimet hetimore për grumbullimin e provave si këqyrja e vendit të ngjarjes dhe këqyrja e automjetit tip “****”. Janë kryer aktekspertimet balistike nr. ***, datë 26.10.2013, dhe nr. ***, datë 12.11.2013.

Janë kryer aktekspertimet mjeko-ligjore për shtetasit E dhe E.S, ku përshkruhen dëmtimet e shkaktuara.

Nga shpjegimet e shtetasve E.S dhe E. S ka rezultuar se ata ishin konfliktuar disa minuta më parë në një lokal në lagjen “****” me dy shtetas dhe ndërsa po ktheheshin në Patos kanë parë një automjet që po i ndiqte. Në momentin që deklaruesit i kanë ndaluar për të parakaluar mjetin, nga ky i fundit është qëlluar me armë zjarri në drejtim të tyre duke kaluar pranë pjesëve të buzës së E dhe dëmtuar në pjesën e hundës E. Ata kanë fiksuar se mjeti ka qenë me ngjyrë të zezë me tek derë. Këta shtetas janë larguar me shpejtësi drejt Patosit.

Nga shpjegimet e shtetasës Z.B rezulton se shtetasit e dëmtuar E.S dhe E.S të jenë konfliktuar fizikisht me të pandehurit Sh (A) K dhe A.M. Këta të fundit janë larguar me një mjet të vogël me ngjyrë të zezë.

Sipas shpjegimeve të shtetasës S.H, ajo ka në pronësi të saj automjetin tip “****”, me targa AA ***, të cilin në datën e ngjarjes e ka pasur i fejuari i saj, i pandehuri A. M, i cili i ka treguar se është konfliktuar tek një lokal te vendi i quajtur *** dhe ka qenë së bashku me një djalë që i thërrasin “Sh”.

Gjithashtu, nga shpjegimet e shtetasit J.M ka rezultuar se rreth orës 23:30 është marrë në telefon nga i afërmi i tij, i pandehuri A. M, ku janë takuar te vendi i quajtur karburanti “****”, i cili ka qenë i shoqëruar me një person që i thërrasin “Sh”, me emrin A.

Nga këqyrja e automjetit me targa AA *** është gjetur karta e identitetit e të pandehurit A.M.

Të dëmtuarit E.S dhe E.S kanë njohur mjetin me targa AA *** si mjetin nga i cili janë qëlluar me armë zjarri.

Nga tabulatet e komunikimit rezulton se i pandehuri A. M ka komunikuar datën e ngjarjes me deklaruesit S.H dhe J.M. Nga shpjegimet e të pandehurve Sh.K dhe A.M rezulton i provuar fakti sa më sipër, ndërsa përcaktojnë njëri-tjetrin si autorë të goditjes me armë drejt mjetit ku kanë qenë shtetasit E.S dhe E.S.

Në këto kushte, provohet se pikërisht i pandehuri Sh.K ka qenë shkak për konfliktin me shtetasit E.S dhe E.S dhe se mjeti ka qenë në përdorim të të pandehurit A.M. Rezulton se i pandehuri Sh. K është personi i cili ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të mjetit ku gjendeshin shtetasit e mësipërm, ndërsa i pandehuri A.M ka qenë në drejtim të mjetit duke bashkëpunuar gjatë kryerjes së veprës penale.

Sa më sipër, rezulton se me veprimet e tij i pandehuri Sh.K ka konsumuar elementet e veprave penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79/dh-22 dhe 25 dhe 278/4 të Kodit Penal, ndërsa i pandehuri A.M ka konsumuar elementet e veprës penale “vrasje në rreth a të tjera cilësuese”, të parashikuar nga nenet 79/dh -22 dhe 25 të Kodit Penal. Prokurori i ngarkuar me hetimin e kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit Genci Mane, në datën 9.10.2013, bazuar në nenet 287 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale, ka regjistruar procedimin penal për veprat penale “vrasje

në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79/dh-22, 25 dhe 278/4 të Kodit Penal dhe emrat e shtetasve Sh.K dhe A.M si persona nën hetim.

Mbështetur në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori Genci Mane, në datën 28.5.2014 ka marrë vendim për dërgimin e çështjes në gjyq.

Në përfundim të gjykimit prokurori ka kërkuar:

- i. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh. K për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe dënimin e tij me 18 vjet burgim.
- ii. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh.K për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe dënimin e tij me 9 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal dhe nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij përfundimtar me 18 vjet burgim.
- iii. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.M për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe dënimin e tij me 18 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij përfundimtar me 12 vjet burgim.

Konkluzionet mbajnë datën e përpilimit të tyre dhe janë nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Genci Mane.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 5.10.2015, ka vendosur:

- i. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh. K për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese, mbetur në tentativë dhe dënimin e tij me 14 vjet burgim.
- ii. Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh.K për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 14 vjet e 8 muaj burgim.
- iii. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.M për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 7 vjet e 4 muaj burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 30.6.2016, ka vendosur:

- i. Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për akuzën “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” për dy të pandehurit.
- ii. Ndryshimin e masës së dënimit për akuzën “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” në ngarkim të të pandehurit Sh.K dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 10 vjet e 8 muaj burgim.

Dosja 5

Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 5.5.2014, me të pandehur G.K, akuzuar për veprën penale “drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 30.7.2014.

Rrethanat e faktit

Nga aktet e hetimeve paraprake ka rezultuar se në datën 3.5.2014, rreth orës 05:45, i pandehuri G.K, duke drejtuar motoçikletën në rrugën *** - *** është goditur nga një mjet kamionçinë me ngjyrë të bardhë në dorezën e motorit.

Mjeti i mësipërm është larguar nga vendi i ngjarjes pa u identifikuar, ndërsa i pandehuri G.K ka marrë ndihmë pranë lokalit “****”.

I pandehuri ka kallëzuar faktin e mësipërm në datën 4.5.2014 kur ka marrë mjekim pranë Spitalit Rajonal Fier.

Sipas aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 8.5.2014, mbi ekzaminimin e shtetasit G.K rezulton shembje e gjoksit nga ana e majtë, thyerje e dy brinjëve të anës së majtë, dërrmishje në fytyrë. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë jo të mprehtë dhe kërkojnë mbi 9 ditë paaftësi të përkohshme për punë.

Sipas aktekspertimit auto-teknik datë 8.5.2014, nuk mund të përcaktohet shkaku determinant për aksidentin, pasi mungon vendngjarja. Gjithashtu, sipas aktit rezulton se i pandehuri ka shkelje të rregullave të qarkullimit për mungesën e lejes së drejtimit të motomjetit.

Sipas shkresës nr. *** prot., datë 8.7.2014, të DRSHTRR-së Fier, i pandehuri G.K nuk është i pajisur me leje drejtimi.

Sa më sipër, rezulton që me veprimet e tij i pandehuri G.K të ketë konsumuar elementet e veprës penale “drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit Genci Mane, në datën 5.5.2014, bazuar në nenet 287 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe emrin e shtetasit G.K si person nën hetim.

Mbështetur në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori Genci Mane, në datën 30.7.2014 ka marrë vendim për dërgimin e çështjes në gjyq. Dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykim” është i strukturuar dhe përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale.

Prokurori Genci Mane, në datën 27.10.2014 ka paraqitur konkluzionet përfundimtare sipas kërkesave të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, në seancën gjyqësore të zhvilluar në ngarkim të të pandehurit G.K. Në përfundim të gjykimit, prokurori ka kërkuar:

- i. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.K, për veprën penale “drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim.

- ii. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 4 muaj burgim.
- iii. Aplikimin e nenit 63 të Kodit Penal, duke pezulluar vuajtjen e dënimit dhe caktimin të përmbushë një punë me interes publik për 200 orë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 27.10.2014, ka vendosur:

- i. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.K, për veprën penale “drejtim të mjetit në mënyrë të parregull”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim.
- ii. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 4 muaj burgim. Aplikimin e nenit 63 të Kodit Penal, duke detyruar të përmbushë një punë me interes publik për 120 orë.

Nga veprimet e kryera nga prokurori Genci Mane duket se janë respektuar veprimet procedurale për ndjekjen e hetimit ndaj të të pandehurit G.K për veprën penale “drejtim të mjetit në mënyrë të parregull”.

Por subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka ndjekur çështjen dhe nuk ka bërë asnjë veprim hetimor ndaj personit tjetër i cili ngiste kamionçinën dhe ka goditur shtetasin G. K.

Për moskryerjen e veprimeve për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe moskryerjen e veprimeve të plota hetimore për personin tjetër, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi se: *“Në lidhje me këtë procedim e vërteta është se unë si prokuror kam kryer hetimet të plota dhe objektive jo vetëm për të pandehurin G. K, por edhe për autorin e larguar nga vendi i aksidentit.*

Në përfundim të hetimeve kam vendosur në datën 30.7.2014 ndarjen e akteve të procedimit për 2 vepra penale.

Ky procedim është pezulluar për moszbulim autori dhe aktet i kanë kaluar shërbimeve të policisë për veprime të mëtejshme në funksion të zbulimit të autorit”.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni konstatoi se në përfundim të hetimeve subjekti i rivlerësimit, në bazë të nenit 93 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 30.7.2014 ka vendosur ndarjen e akteve të procedimit me nr. ***, duke regjistruar kështu dhe procedimin penal nr. *** për veprën penale “largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodi Penal.

Ky procedim rezultoi se është pezulluar për moszbulim autori me vendimin e datës 15.12.2014 dhe aktet i kanë kaluar shërbimeve të policisë së rrethit për veprime të mëtejshme në funksion të zbulimit të autorit të ngjarjes.

Nuk u konstatuan problematika lidhur me ndjekjen e këtyre dy çështjeve penale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Të dhëna të tjera

Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se subjekti Genci Mane:

- i. Nuk ka pasur masa disiplinore.
- ii. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.
- iii. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar katër kallëzime penale, të cilat janë pushuar.

Analiza e gjetjeve

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Genci Mane, ka treguar korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tre aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosje e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Në shumicën e rasteve analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

Komisioni konstaton se ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. ***, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”.

Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

Subjekti i rivlerësimit Genci Mane shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme. Aktet e përpiluara prej tij janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e tyre formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori.

Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Subjekti i rivlerësimit Genci Mane ka ushtruar kompetencat që ligji i njeh prokurorit në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes të policisë gjyqësore.

Prokurori ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikat 2 dhe 2.1 të urdhrit nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”.

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij ka qenë në përgjithësi brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale, ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mos përgatitjen e tij për çështjen në gjykim.

Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNJ-së, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Genci Mane, është eficient dhe efektiv. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 10 denoncime, si vijon:

1. Denoncim nr. * prot., datë 20.10.2020 dhe nr. *** prot., i *** P.** Ky subjekt denoncon disa subjekte rivlerësimi. Denoncimi është paraqitur në formën e kërkesës drejtuar për kompetencë Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi nuk u konstatuan fakte apo rrethana, të tilla që të përbënin prova për gjetje mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko-profesional.

2. Denoncim nr. * prot., datë 29.12.2017, i shtetasit A.R,** i cili denoncon gjithsej 20 subjekte rivlerësimi. Nuk rezultuan *indicie* për shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit nga ky denoncim.

3. Denoncim nr. * prot., datë 15.5.2018, i shtetasit L.M,** i cili ka denoncuar shumë subjekte, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit. Nuk rezultuan *indicie* për shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit nga ky denoncim.

4. Ankesë nr. * prot., datë 18.5.2020, e shtetasit A.S,** i cili denoncon subjektin e rivlerësimit për caktimin e masës së sigurimit personal dhe veprime antiligjore.

Për këtë i është kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dosja penale në ngarkim të këtij shtetasi.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, ka dërguar praktikën lidhur me procedimin penal me të pandehur A.S. Bazuar në këtë praktikë rezultoi se denoncuesi ka paraqitur ankesë pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD) për shkelje të mundshme të kryera nga subjekti i

rivlerësimi. Pas shqyrtimit të kërkesës, ILD ka dalë me vendimin nr. ***, datë 19.1.2021, për arkivimin e kërkesës së paraqitur nga denoncuesi. Hetimi i kryer nga ILD-ja ka analizuar shkeljet e mundshme të subjektit të rivlerësimi (kur ka dyshime të arsyeshme dhe konstatohen veprime apo mosveprime dhe sjellje të magjistratit që mund të përbejnë shkelje disiplinore) dhe ka vendosur arkivimin e kërkesës. ILD-ja ka vlerësuar se për subjektin e rivlerësimi nuk ngrihen dyshime të arsyeshme se sjellja apo veprimet e tij janë të natyrës së tillë që të përbejnë shkelje disiplinore sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, nuk rezultuan *indicie* për shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimi nga ky denoncim dhe ndodhemi përpara gjësë së gjykuar.

5. Denoncimet nr. * prot., datë 11.4.2018, dhe nr. *** prot., datë 23.1.2019, të shtetases L. Z,** e cila denoncon disa subjekte rivlerësimi për shkelje ligjore dhe shpërdorim detyre. Denoncuesja pretendon dënim të padrejtë të djalit të saj, pasi e konsideron të pafajshëm. Nuk është paraqitur ndonjë vendim i subjektit për t'u vlerësuar. Rezultoi se çështja ndaj djalit të denoncueset është ndjekur deri në Gjykatën e Lartë, ku është vendosur edhe dënimi i tij për veprat penale përkatëse.

6. Denoncim nr. * prot., datë 11.5.2020, i shtetases A. B,** e cila denoncon se sipas saj vendimi nr. ***, datë 11.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është antiligjor dhe i pa mbështetur në prova dhe fakte, pasi ka dënuar vëllain e saj me 10 vjet heqje lirie. Në denoncimin e saj denoncuesja ka përmendur edhe subjektin e rivlerësimi për shkak se ka bërë cilësim të gabuar të kualifikimit të veprës penale. Nuk ekzistojnë *indicie* për vlerësim ndaj subjektit të rivlerësimi, pasi cilësimi i veprës penale bëhet nga prokurori pas analizimit të fakteve rrethanave dhe provave dhe bazuar në bindjen e tij të brendshme. Është gjykata pastaj e cila vendos bazuar në prova dhe fakte dhe mbrojtjen e palëve. Çështja e denoncueses për dënim më të ulët dhe jo ekstrem është objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga gjykata dhe palët duhet të ndjekin ankim në gjykatën më të lartë.

7. Denoncimet nr. * prot., datë 11.5.2022, nr. *** prot., datë 11.5.2022, nr. *** prot., datë 19.5.2022, dhe nr. *** prot., datë 30.5.2022, të shtetasit R.H dhe denoncim nr. *** prot., datë 26.10.2020, i avokatit N.D.** Ky denoncues denoncon subjektin e rivlerësimi për shtyrje të çështjeve në mënyrë joprofesionale. Në denoncim mungojnë të dhëna lidhur me çështjen për t'u marrë në konsideratë dhe vlerësim dhe u kërkuar nga Komisioni praktika përkatëse.

Me shkresën nr. *** prot., datë 7.11.2022, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i është kërkuar dërgimi i praktikës që ka të bëjë me çështjen penale ndaj shtetasit R.H. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2022, ka dërguar praktikën përkatëse.

Bazuar në këtë praktikë rezultoi se çështja penale ndaj shtetasit R.H ka filluar pas referimit të veprës penale nga oficeri i policisë gjyqësore së DVP Fier (datë 25.8.2020) si person i dyshuar për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”. Rezultoi se shtetasi R.H në datën 24.8.2020, duke drejtuar automjetin e tij është përfshirë në karambol me një motoçikletë me drejtues shtetasin O. T. Nga ky karambol

ka marrë dëmtime të rënda dhe më pas ka ndërruar jetë në Spitalin Rajonal Fier shtetasi O. T. Në datën 26.8.2020 subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, ka vlerësuar si të ligjshëm “arrestimin në flagrancë” dhe caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 28.8.2020, ka vlerësuar si të ligjshëm arrestimin e shtetasit R. H. dhe ka caktuar masën “arrest në burg”. Edhe me vendimin e datës 8.9.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier pas ankesës së palës është vendosur mosndryshimi i masës së sigurimit. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fierit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe nuk është pranuar as rekurs në Gjykatën e Lartë. Nuk u konstatuan problematika për subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë çështje penale. Çështjet e ngritura nga avokati i takojnë gjykatës për vlerësim.

8. Denoncim nr. * prot., datë 9.2.2022, i shtetasit A.B,** i cili denoncon subjektin e rivlerësimit për zvarritje të procesit.

Për këtë i është kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dosja penale në ngarkim të këtij shtetasi.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, ka dërguar praktikën lidhur me procedimin penal me të pandehurin A B. Bazuar në këtë praktikë rezultoi se denoncuesi ka paraqitur ankesë pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për shkelje të mundshme të kryer nga subjekti i rivlerësimit. Pas shqyrtimit të kërkesës, ILD ka dalë me vendimin nr. ***, datë 10.2.2021, për arkivimin e kërkesës së paraqitur nga denoncuesi. Hetimi i kryer nga ILD-ja ka analizuar shkeljet e mundshme të subjektit të rivlerësimit dhe ka vendosur arkivimin e kërkesës. ILD-ja ka vlerësuar se për subjektin e rivlerësimit nuk rezultuan fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit për kryerje të shkeljeve disiplinore dhe as ndonjë shkelje tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Për sa më sipër, nuk rezultuan *indicie* për shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit nga ky denoncim dhe ndodhemi përpara gjësë së gjykuar.

9. Ankesë nr. * prot., datë 12.2.2018, e shtetases V.P,** e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore. Në materialin shoqërues të denoncimit rezulton se prokurori ka ndjekur çështjen penale dhe ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 20.5.2016. Vendimi i prokurorit është bazuar pas kryerjes së një sërë hetimesh, në hetimin e kryer lidhur me rrethanat, pyetjen e personave, aktekspertimet përkatëse, kartelën mjekësore dhe mendimin e oficerit të policisë gjyqësore. Nuk rezultuan problematika për subjektin e rivlerësimit në ndjekjen e kësaj çështjeje penale.

10. Ankim nr. * prot., datë 4.7.2022, i shtetases V.N.** Kjo shtetase ka paraqitur ankim kundër veprimeve të paligjshme dhe joligjore të disa prokurorëve dhe gjyqtarëve të rrethit gjyqësor Fier. Ankesa ka të bëjë kryesisht me pretendimet për moskryerje të veprimeve hetimore nga prokurori i çështjes P. V. Ankuesja pretendon gjithashtu se ka bërë kërkesë për takim dhe zëvendësimin e prokurorit të çështjes te subjekti i rivlerësimit, për të cilën nuk ka marrë përgjigje. Bashkëlidhur është paraqitur dhe një kërkesë drejtuar subjektit të rivlerësimit në datën 15.6.2022 për zëvendësimin e prokurorit të çështjes. Nuk rezultuan problematika për subjektin e rivlerësimit në ndjekjen e kësaj çështjeje penale.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Genci Mane, me funksion prokuror, *ka kryer deklarin të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal.*

Nga analiza e bërë nga Komisioni u konstatuan disa problematika, të cilat vijnë si rezultat i mosveprimeve të kryera në kohë nga subjekti për të shmangur çdo dyshim të mundshëm në dukje. Por këto veprime apo mosveprime të subjektit nuk mund të çojnë në konkluzionin se ndodhemi përpara një deklarin të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore referuar nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti ka kryer deklarin të saktë të pasurive dhe interesave private, si dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive në pronësi. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij dhe personave të lidhur.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Genci Mane për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*) dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si prokuror.

Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Genci Mane ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të

çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, konstaton se subjekti i rivlerësimit Genci Mane ka arritur një nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe të aftësive profesionale.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, pika 1 e nenit 58 dhe të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Genci Mane, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 13.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi